

NJOFTIM PËR APLIKIM

PËR

FUNKSIONIN E INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM TË INSPEKTORATIT TË PËRGJITHSHËM

Në mbështetje të ligjit nr.99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe të vendimit nr.13, datë 15.1.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve të veçanta dhe të procedurave për përzgjedhjen, emërimin, vlerësimin e rezultateve në punë, disiplinën, lirin dhe shkarkimin nga detyra të Inspektorit të Përgjithshëm”, shpallim njoftimin për aplikim për funksionin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Përgjithshëm.

Inkurajojmë të gjithë të interesuarit, të cilët përmbushin kriteret, të aplikojnë!

Kandidati për pozicionin e Inspektorit të Përgjithshëm duhet të plotësojë kriteret si më poshtë:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të ketë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë pune në pozicione të larta drejtuese në institucione publike ose private;
- ç) Të ketë diplomë të nivelit “Master i shkencave” apo “Master profesional”, të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vjet akademike ose të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
- d) Të ketë integritet moral dhe profesional;
- dh) Të mos jetë dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- e) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;
- ë) Të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës.

Dokumentet që duhet të dorëzohen janë:

- a) Kërkesa për aplikim;
- b) Jetëshkrimi i përditësuar (CV);
- c) Kopja e diplomës dhe e listës së notave;
- ç) Dëshmia e përvojës profesionale;
- d) Vetëdeklarimi për konfliktin e interesit dhe papajtueshmërinë sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Kopja e letërnjoftimit (ID);
- e) Vërtetimi nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- ë) Vetëdeklarimi i gjendjes gjyqësore;
- f) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimimin shtesë, publikimet, angazhimet akademike apo të tjera, të përmendura në jetëshkrim.

(Deklarimi i rremë, përveç përgjegjësisë penale sipas ligjit, sjell përjashtimin nga çdo procedurë e mëtejshme.)

Afati i dorëzimit të aplikimit, deri më 30 janar 2026.

Adresa: Kryeministria

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1.

Tiranë, Shqipëri

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm

Tel.: 00355 4 22 77 401